Nr. _____Prot **Tiranë, më 30.10.2026**

Rregullore e Promocionit "Loja Promocionale OX NË DORË, iPHONE NË LOJË " të organizuar nga

"LAJTHIZA INVEST SHA"

1. Subjekti organizues i promocionit "Loja Promocionale OX NË DORË. IPHONE NË LOJË" është shoqëria Lajthiza Invest Sha , me NIPT J98009202P, me seli në adresën: Shkoder, Bashkia Fushe Arrez, Njesia Administrative Qafe Mali.

2. Promocioni **"Loja Promocionale OX NË DORË. IPHONE NË LOJË "** do të zhvillohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Në promocionin "Loja Promocionale OX NË DORË. IPHONE NË LOJË " mund te marrin pjesë të gjithë personat, mbi 18 vjec, pavarësisht vendndodhjes në Shqipëri, të cilët do të blejnë produktet OX dhe OX frut pasioni në paketimet : kanace 250ml, përgjatë periudhës së promocionit Nentor- Dhjetor 2026. Fushata do të shtrihet në të gjithë Shqipërinë, duke synuar një audiencë të gjerë konsumatorësh mbi 18 vjeç, përmes reklamave të sponsorizuara në Facebook dhe Instagram. Produktet e sipër përmendura duhet të jenë të prodhuara nga Lajthiza Invest Sha.

4. Produktet e Lajthiza Invest Sha të përfshira në këtë promocion do të shiten me çmimin normal të tregut. Çmimi i rekomanduar i tregut për këto produkte gjëndet në tabelën më poshtë:

Emërtimi	Formati	Cmimi I rekomanduar (Pa Tvsh)	Cmimi I rekomanduar (Me Tvsh)
OX	**Formati 250 ml**	**ALL 66.67**	**ALL 80.00**
OX frut pasioni	**Formati 250 ml**	**ALL 66.67**	**ALL 80.00**

Për të marrë pjesë në promocion, konsumatorët duhet të blejne një nga produktet e siperpërmendura, të skanojë QR Code në kanaçen OX, më pas konsumatori drejtohet në një landing page të dedikuar, ku plotëson emrin, mbiemrin, numrin e telefonit dhe ngarkon fotografinë e faturës fiskale të blerjes. Pas verifikimit të faturës, regjistrimi konfirmohet dhe

konsumatori bëhet pjesëmarrës në shortin shpërblyes. Nje konsumator ka te drejte te marrë pjese me shumë se një herë.

Për zhvillimin dhe administrimin e lojës promocionale , do të përdoret një platformë elektronike (website). Website në të cilën do të realizohet loja , është website i Lajthiza Invest Sha : www.lajthiza.al . Ky website menaxhohet nga agjensia TOK DIGITAL AGENCY, me nipt L62126009T, me seli në adresën Rruga Abdyl Frasheri.

Shoqëria e cila do të menaxhojë, monitorojë website dhe ku do të bëhet përzgjedhja rastësore e fituesve për këtë promocion është Agjensia e marketingut Mend Shpk me NIPT M52028021A me seli në adresën: Rruga SAMI FRASHERI, HYRJA 1, Apartamenti 9, Tiranë, Shqiperi. Me shoqërinë Mend Shpk kemi një kontratë bashkëpunimi , për të gjitha shërbimet e marketingut,. Bazuar në kontratën e bashkëpunimit, Mend Shpk do të merret dhe me menaxhimin dhe monitorimin e website për këtë lojë promocionale, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë rregullore dhe legjislacionit në fuqi. Bashkëngjitur dhe kontrata e bashkëpunimit.

Mekanizmi i promocionit “Loja Promocionale OX NË DORË, IPHONE NË LOJË ” konsiston në një kombinim të formulave “Bëj blerje të një produkti në paketimet kanaçe 250ml, hyr në website , ngarko faturën e blerjes ku duhet të lexohet blerja e një prej produkteve pjesë e promocionit dhe apliko për t’u bërë pjesë e shorteut “OX NË DORË, IPHONE NË LOJË” për të fituar dhurata.

Fushata do të mbështetet në një komunikim dinamik në rrjetet sociale, me përmbajtje vizuale dhe video që vendosin OX në qendër të vëmendjes, duke ndërthurur identitetin e brandit, dy variantet e produktit dhe çmimet shpërblyese.

Përmes reklamave të sponsorizuara në Meta (Facebook & Instagram), synohet të arrihen konsumatorë në të gjithë territorin e Shqipërisë, duke krijuar njohje për produktin dhe duke i nxitur drejt blerjes dhe pjesëmarrjes në promocion.

Për të marrë pjesë në promocionin “Loja Promocionale OX NË DORË. IPHONE NË LOJË ” dhe për të fituar çmimet e vëna në dispozicion nga Lajthiza Invest Sha, pjesëmarrësit duhet të ndjekin udhëzimet vijuese të përcaktuara në këtë rregullore.

- Konsumatori duhet të jetë mbi 18 vjec.
- Konsumatori duhet të blejë një nga produktet OX pjesë e kësaj Loje promocionale.
- Konsumatori duhet të skanojë ‘QR’ kod që gjëndet në kanaçe.
- Konsumatori duhet të plotësojë të dhënat e kërkuara në aplikacionin dhe të ngarkojë faturën fiskale ku të lexohet blerja e minimalisht një produkti OX, dhe të perfundojë regjistrimin.

• Loja promocionale do të jetë e vlefshme: Nga data 01 Nentor 2026 deri në datën 20 Dhjetor 2026.

• Hedhja e shorteut për përzgjedhjen e 4 fituesve do të bëhet një ditë mbas mbylljes së promocionit , në praninë e një noteri publik ose te As/Noterit të autorizuar nga Lajthiza Invest Sha.

Datat dhe orari i hedhjes se shorteut do te jene: **21 Dhjetor 2026 ora 11:00**

4 Fituesit që do të përzgjidhen do fitojnë secili, nga 1 iPhone 17 Pro Max ose iPhone 18 Pro Max..

Fituesit do të zgjidhen në mënyrë rastësore. Përzgjedhja e fituesve të lojës promocionale do të realizohet në mënyrë rastësore, nëpërmjet një sistemi elektronik të integruar ose të përdorur për këtë qëllim në website-in e lojës promocionale.

Pas përfundimit të periudhës së pjesëmarrjes, sistemi do të kryejë përzgjedhjen rastësore të fituesve nga lista e pjesëmarrësve që përmbushin kushtet e përcaktuara në këtë rregullore.

Sistemi mbledh në një excel të gjitha të dhënat e gjeneruara nga webi, pastaj këto të dhëna verifikohen dhe kalohen në sistemin automatik për përzgjedhje.

Procesi i përzgjedhjes do të administrohet dhe mbikëqyret nga agjencia e marketingut Mend Shpk , e cila është përgjegjëse për administrimin e pjesëmarrjeve, zhvillimin e shortit, dokumentimin e rezultateve dhe njoftimin e fituesve.

Rezultatet e shortit do të dokumentohen dhe fituesit do të njoftohen nëpërmjet të dhënave të kontaktit të deklaruara gjatë regjistrimit në lojë, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore. Përzgjedhja e fituesve do të kryhet në mënyrë të paanshme dhe transparente, duke garantuar trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit që plotësojnë kriteret e pjesëmarrjes. Noteri do të certifikojë me anë të një procesverbali, i cili do të mbahet në momentin e hedhjes së shorteut dhe përzgjedhjes së fituesit.

Ky procesverbal do të firmoset nga përsonat e pranishëm të cilët do të jenë; një punonjës i autorizuar nga Lajthiza Invest Sha , një punonjës i autorizuar nga Agjensia Mend Shpk, një punonjës i autorizuar nga Autoriteti Mbikqyrës i Lojrave të Fatit, një inspektor i autorizuar nga Drejtoria e Tatimeve si dhe Noteri Publik dhe/ose As/Noterit të autorizuar nga Lajthiza Invest Sha.

• Ditët e pushimit do të zëvendësohen nga dita parardhëse ose pasardhëse.

• Vendi ku do të hidhet shorteu për zgjedhjen e fituesit do te jete prane Agjensise Mend shpk me adrese: Rruga SAMI FRASHERI, HYRJA 1, Apartamenti 9, Tiranë, Shqiperi. Mënyra e

perzgjedhjes së fituesit do të jetë rastësore nga sistemi.. Fitues i një shorteu do te konsiderohen 4 personat e parë, numrat e tjerë do të mbahen rezervë.

Gjatë kohëzgjatjes së ketij promocioni, konsumatorët do të kenë mundësinë të fitojnë në total:

- 4 dhurata
- Vlera totale e dhuratave është si më poshtë:

Pershkrimi	**Sasi / Cope**	**Dhurata e Lojes Promocionale**	
		Cmim/njësi (ALL, pa TVSH excl.)	**Total (ALL, pa TVSH excl.)**
iPhone 17 Pro Max	2	105’000	210’000
iPhone 18 Pro Max	2	129’166	258’332
Total me TVSH			**561’998**

*Çmimi nuk është i konvertueshem në para.

Numri i parashikuar i pjesëmarrësve në promocionin “Loja Promocionale OX NË DORË. IPHONE NË LOJË ” është rreth 10’000 .

Shpërndarja e dhuratave do të bëhet në ambientet e Mend Shpk . Fituesit mund të tërheqin dhuratën nga e Hëna në të Premte, nga ora 10:00-16:00 nga data 22 Dhjetor 2026 deri më 22 Janar 2027. Tërheqja e dhuratës mund të kryhet vetëm me paraqitjen e dokumentit të identifikimit të fituesit. Në rast të pamundësisë së paraqitjes fizikishtë të fituesit, mund të paraqitet një përson i autorizuar më prokurë të posatshme nga noteri për tërheqjen e dhuratës. Në momentin e marrjes së dhuratës, fituesi duhet të nenshkruaje procesverbalin e marrjes në dorëzim të dhuratës.

Fituesi duhet të paraqitet në adresen e përcaktuar, për tërheqjen e dhuratës brenda një harku kohor prej 30 ditësh nga data e shpalljes fitues. Nëse Fituesi nuk do të paraqitet brenda afatit ditor prej 30 ditë, për të tërhequr dhuratën, ai pranon se nuk do të ketë asnjë pretendim ndaj Lajthiza Invest Sha , lidhur me dhuratën e përfituar, pasi ai humb të drejtën si fitues i këtij

Promocioni dhe Lajthizes i lind e drejta të shpallë fitues personin pasardhës të përzgjedhur në të njejtën ditë me fituesin , që ka refuzuar të tërheqë dhuratën.

Pjesëmarrës në shorte do të jenë të gjithë konsumatorët që kanë aplikuar në web për t'u bërë pjese e lojës promocionale OX NË DORË. IPHONE NË LOJË gjatë periudhës se promocionit: 01 Nentor 2026 – 20 Dhjetor 2026.

Fituesi do të:

a. Njoftohet me telefonatë brenda ditës së hedhjes së shorteut. Nëse fituesi nuk përgjigjet në telefon, brenda 5 dite pune , atëherë Lajthizes i lind e drejta të shpallë fitues përsonin pasardhës.

b. Në rast se fituesi nuk përgjigjet në telefon pranon se nuk do të ketë asnjë pretendim per dhurate dhe humbet të drejtën si fitues i këtij Promocioni.

c. Duhet të dërgoje kredencialet e plota si: emër, mbiemër, atësi, numrin e kartës së identitetit, qytetin dhe adresën e saktë të banimit.

d. Të gjitha të dhënat personale do të përpunohen nga Lajthiza dhe Agjensia e marketingut Mend shpk ,vetëm për qëllimin e këtij promocioni, vetëm pas miratimit te kushteve dhe termave të privatsisë për përpunimin e këtyre të dhënave nga ana e aplikuesve në llogarinë e krijuar e sipas rregullores përkatese dhe do të shkatërrohen brenda 14 ditëve nga përfundimi i dorëzimit të dhuratës, sipas ligjit në fuqi, duke mos lejuar humbjen, ndryshimin, përhapjen e pa-autorizuar ose ndërhyrjen te të dhënat personale të transmetuara, ruajtura apo përpunuara.Të dhënat personale të mbledhura nga Lajthiza Invest sha dhe Agjensia Mend shpk në kuadër të këtij promocioni sipas kushteve të kësaj rregullore dhe kushteve te privatsisë të pranuara nga fituesit apo pjesëmarrësit në momentin e plotësimit të dhënave te kërkuara në aplikacionin do të trajtohen në përputhje me Ligjin "Nr.124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

e. Lajthiza Invest Sha nuk do të jetë përgjegjëse për asnjë dëm financiar apo jofinanciar (përfshirë dëmin apo fitimin e munguar) që mund të rezultojë si pasojë e pjesëmarrjes në promocionin "Loja Promocionale OX NË DORË. IPHONE NË LOJË " përjashtuar përgjegjësinë ligjore të Lajthizes.

f. Të gjithë pjesmarrësit në lojën promocionale duhet të jenë në dijeni se të dhënat e fituesve në këtë lojë promocionale do të shpallen në faqen zyrtare të lojës promocionale "Loja Promocionale OX NË DORË. IPHONE NË LOJË " dhe bien dakord që të dhënat e tyre të jenë publike në faqen zyrtare pas shpalljes së fituesit deri më datë 31 Dhjetor 2026.

g. Pjesëmarrësit në këtë promocion nuk kanë të drejtë të kërkojnë çmim në sasi më të madhe, apo çmim të ndryshëm nga ai i përcaktuar nga subjekti organizues i fushatës sipas kësaj rregulloreje. Çmimet e mësipërme nuk janë të konvertueshme në para. Duke marrë pjesë në këtë promocion, pjesëmarrësit detyrohen të respektojnë këtë rregullore.

h. Promocioni "Loja Promocionale OX NË DORË. IPHONE NË LOJË " mund të ndërpritet në rast force madhore dhe/ ose Fatkeqësie Natyrore (rrethana të cila Shoqëria nuk mund t'i kishte parashikuar apo influencuar), përfshirë pamundësinë e Lajthizes për të vazhduar promocionin "Loja Promocionale OX NË DORË. IPHONE NË LOJË " për arsye që nuk varen nga vullneti i saj. Lajthiza do të informojë konsumatorët me mjetet e duhura në rast ndërprerjeje të promocionit "Loja Promocionale OX NË DORË. IPHONE NË LOJË " duke dhënë edhe arsyet e kësaj ndërprerjeje. Në raste të tilla, Lajthiza nuk do të ketë detyrimin për të dëmshpërblyer pjesëmarrësit për çdo shpenzim lidhur me pjesëmarrjen e tyre në promocion.

i. Promocioni "Loja Promocionale OX NË DORË. IPHONE NË LOJË " është një promocion që i drejtohet publikut dhe bazohet në nenet 661, 665, 667 paragrafi i parë dhe i tretë, 670 e 671 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Organizimi i Loja Promocionale OX NË DORË. IPHONE NË LOJË " bëhet në përputhje me Ligjin 155 /2015 "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërise" i ndryshuar me Ligjin nr. 75/2018 datë 25.10.2018 si dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 196, datë 15.3.2017 "Përcaktimin E Mënyrave, Formave, Kritereve Dhe Rregullave Për Organizimin E Lojërave Të Fatit Promocionale". Personat që sipas parashikimeve të kësaj rregullore kanë të drejtë të tërheqin çmimet e vëna në lojë, nëse hasin pengesë në tërheqjen e tyre mund të paraqesin çdo ankesë apo informacion në numrin e tel: +355 69 447 3660 ose ne adresën e-mailit: info@lajthiza.al.

OX është marke e regjistruar e "Lajthiza Invest Sha ".

Këto rregulla do të botohen pjesërisht në materialet promocionale dhe plotësisht në website (www.lajthiza.al).

Me respekt,
Valbona Alushi
Drejtoreshë Finance
Lajthiza Invest Sha